



Data: 05.04.2019

Ref.: 565/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.427/19H, datë 15.03.2019 e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si e bazuar.
- II. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.187/19D, datë 11.02.2019.
- III. Aprovohet aplikacioni i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për akreditim të programeve të studimit, Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.187/19D, datë 11.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.

Arsyetimi

KSHC me vendim Nr. 187/19D, datë 11.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS, Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS, dhe Prodhimi Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS.

Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.187/19D, datë 11.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 15.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).


Përmes kësaj ankesa, Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programet e studimit, Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS, i cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.3187/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KShC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit, Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe inicimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

